



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 02

Datë: 30. 01. 2017, ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.01/2017;
 2. Njoftim rreth përgatitjeve për Ditën Globale të Zgjedhjeve;
 3. Raport mbi zbatimin e Planit të Punës së KQZ-së dhe aktiviteteve tjera për vitin 2016;
 4. Propozim-Plani i Punës së KQZ-së dhe aktiviteteve tjera për vitin 2017;
 5. Aktivitetet e ZRPP-së;
- Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për

mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2017;

6. Raport i Këshillave të KQZ-së;

Këshilli për Buxhet dhe Financa - Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2017;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të tremujorit të katërt të shpenzimeve të vitit 2016; □
Këshilli për Çështje Ligjore;

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të KQZ-së dhe USAID-it;

7. Të ndryshme

1. Hyrje

Mbledhja, është kryesuar nga kryetarja, znj. Valdete Daka.

Betim Gjoshi: Kam disa propozime për modifikim të rendit të ditës: e para, pika 5 mendoj që duhet me qenë pika e 2-të, pika e 2 nën 6, me u qitë si pika e 3-të e rendit të ditës, dhe kam për të diskutuar pastaj edhe në pikat e tjera.

Adnan Rrustemi: Nuk e di se është hartuar agjenda e mbledhjes, por për pikë e 2, 3 dhe të 4-të te raporti dhe plani i punës, për mua, raporti i punës - te shqyrtimi dhe miratimi, pra shikimi i aktiviteteve dhe realizimi, tashmë është i tejkaluar, sikurse që bënë fjalë edhe për vlerësimet e zyrtarëve, është i tejkaluar. Sot, nuk mendoj që duhet mund të shqyrtohet, prandaj mendoj që plani duhet t'u nënshtrohet edhe njëherë këshillave, dhe nëse nuk është hequr një punëtori, mendoj që duhet të kthehet dhe të analizohet e plotësohet edhe më tutje dhe pastaj, të miratohet...

Eshref Vishi: Mbasi jemi te rendi i ditës, edhe unë kam disa fjalë: lidhur me përmbajtjen. Rendi i ditës, është i ngjeshur, ka shumë pika për shqyrtim dhe nuk mund të shqyrtohet në mënyrë përmbajtësore. Unë mendoj që të rishikohet dhe të shtyhet për një ditë tjetër, sa më shpejt..

Adnan Rrustemi: Mendoj që ne duhet të përcaktohem për modalitetin, nuk duhet të lëmë dykuptimësi. Nëse e kemi ndërmend miratimin e planit shpejt, duhet ta kthejmë në këshilla ta shqyrtojmë në mënyrë intensive.

Betim Gjoshi: I kemi edhe disa pika të tjera që nuk lidhen me këto, dhe unë propozova modifikimin. Një raport financiar për vitin 2016 nuk na ka ardhur, ndërsa ne edhe mund t'i shqyrtojmë dy pikat e para, dhe jo vetëm sot por edhe nesër, edhe pasnesër dhe mund ti miratojmë pa pasur nevojë t'i rikthejmë në këshilla. Po nëse duam, mund ti rikthejmë sërish në këshilla por për këtë, pasi të arrijmë një qëndrim të përbashkët. Unë, jam i përgatitur ti shqyrtojmë sot...

Plani i punës, është i punuar thjeshtë, domethënë nuk është i komplikuar dhe varet nga ne se a do kemi vërejtje, të shtojmë diçka etj., prandaj, unë them që ta miratojmë njëherë rendin e ditës dhe pastaj...Pra, të fillojmë...

Ilir Gashi: Në raportin financiar të shpenzimeve të vitit 2016, edhe ky deri më 31 të muajit, duhet të miratohet. Nëse e fusim sot, po bëhet rendi voluminoz por, ta lëmë për nesër por,s'mund ta lëmë anash...Ne, sapo e përfunduam mbledhjen e këshillit, s'kishim mundësi ta kishim në agjendë...

Betim Gashi: Gjithësesi, duhet ta kemi edhe raportin, por është edhe plani i prokurimit. Të dyjat, janë të lidhura me planin e punës. Patjetër, duhet të punojmë sot dhe nesër. Duhet të fillojmë me planin e punës, kurse njëra pa tjetrën nuk shkojmë. Ta bëjmë prioritetin e punës...

Valdete Daka: Sot, ti shqyrtojmë dy pikat e para, dhe e fusim edhe raportin financiar.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.01/2017

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së nuk e miratuan procesverbalin nr. 1/2017. Kryetarja, znj. Daka, bëri vërejtjet për mos përfshirjet në procesverbal të diskutimeve. Vërejtjet u bënë edhe nga z. Bajram Ljatifi, Betim Gjoshi, Binak Vishaj, Eshref Vishi.

Valdete Daka: E kthejmë në rishkrim...

Betim Gjoshi: Edhe diçka... Janë dy çështje: Sekretariati duhet ta dërgoj një shkresë se pse Këshillat e Vendvotimit nuk janë paguar. Për çdo ditë po na vinë njerëz, pra duhet me thënë se ende skemi mjete prej buxhetit, për raundin e parë nuk janë paguar ata që kanë pasur pengesa, për raundin e parë janë kaluar datat dhe nuk kemi mundur me zanë buxhetin... Bëjeni një njoftim sepse është me rëndësi me ruajtë integritetin se dikush po mendon se qëllimisht nuk janë tuj u paguar...

E dyta e çështjes, tha z. Gjoshi, ka të bëjë me mbarëvajtjen e punës së KQZ-së. Kur tham për KQZ, tham për turpen prej neve 11 vetve, sot është i 30-ti, a dita e fundit e janarit dhe ka këshilla që s'kan mbajtur këtë vit mbledhje hala, ka këshilla që kanë mbajtur një mbledhje ose hiq...Na duhet me rritë punën tonë..Une kam pas ni ditë kohë, une i kam shiqu 20 e dicka mbledhje që i kemi mbajtur jashtë procesit zgjedhor në Drenas, edhe shumica janë kanë për çështje t'domosdoshme, ose edhe banale...Ka mbledhje për zëvendësim të këshilltarve të kuvendit komunal, që është një detyrë anësore e jona, asnjë mbledhje nuk ka të bëjë me mbikqyrjen, me mbarëvajtjen e punës...Edhe këtu po na grumbullohen qisifar rende të ditës...me apo pa qëllim se une nuk jam prej atyre që ngriji konspiracion, por kjo po na ndodh...Ne, në bazë të rregullores, e kemi njëfar agjende në bazë të së cilës, si funksionon ky far institucioni...Po të drejtohem ty kryetare, bashkë

me kryesuesit e këshillave me e rritë aktivitetin...Si të hyjmë në agjenden zgjedhore, s'do të arrijmë më tutje...

Eshref Vishi: Kur të vijë radha e diskutimeve të agjendes, e shpjegojmë se pse nuk janë bërë pagesat...

Valdete Daka: A po vazhdojmë me fondin për mbështetje...

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Miradije Mavriqi, drejtoresh e ZRPP-së tha se, draft vendimi është i përgatitur duke u bazuar në ligj, konkretisht në nenin 9...Kjo është për një vit, janë shpjegimet e duhura...

Eshref Vishi: Faktikisht, keni pas shkurtime për 1499 euro për 2016 në Fondin për Demokratizim...Për 2017, a është 4 milion e 200 mijë, apo përsëri është i reduktuar...?

Betim Gjoshi: Po e shpjegoj unë drejtoresh se, zor që t'i din me e shpjegue...! Nuk ju ka shkurtu buxheti, këta e kanë luajtur njëfar fiskullture se jav kanë marrë me të 28-in atë që s'kan harxhitë pare...domethënë k'ta e kanë pasqyruar si shkurtim...Cka se kanë harxhitë jav kanë marrë se, nuk a harxhu buxheti...

Valdete Daka: Domethënë 4 milion e 200 mijë janë...i dinë përmes ulseve sa janë...Po de,secila parti e din se sa ulëse i ka...

Sami Hamiti: S'ua ka prekur askush, po janë mbetur mjetet e pashfrytësuar edhe shkojnë në suficit...

Enis Halimi: Kjo është e vëretetë: një pjesë të mjeteve nuk kemi mundur me i shpenzuar...Por është shumë e vërtetë që disa antërë të Këshillave të Vendotimeve dhe stafin në QNR, i kemi dërguar në përputhje me afatet, një javë ose dhjetë ditë përpara...Nga ana jonë, janë kryer...

Ercan Spat: M'doket se u përziën gjanat, kolegu i jonë zotëri Eshrefi përmendi njëmijëe disa euro t'cilat i kan harxhu grupet parlamentare t'subjekteve politike...S'kan t'bajnë me mosharxhimet t'Sekretariatit tonë, ashtu q'i ajo është punë tjetër..t'mos përzijmë punë, esenca n'kit rast...

Betim Gjoshi: Po e marrim vendimin si edhe herave të tjera: E para, ne duhet të kërkojmë nga administrata sa ma shpejt me implementu vendimin...Njerëzit janë pa rroga...është mirë bile partive me ua nise mjetet, e mandej edhe grupeve parlamentare...E dyta, kam një çështje që është mirë me e diskutuar...! Kemi të bëjmë me dy kategori tjera jashta partive politike që, ne po ju dajmë mjete po subjektivitetin e tyre bazuar në ligj të personave juridik, nuk e kan...!

është problematike kjo punë, tha z. Gjoshi. Po d'u me ngritë si çështje, mbi të gjitha, ne është

dashur me pas një akt nënligjor që e krijon këtë punë...Ne kem me pas probleme, edhe kemi probleme, sidomos kur kanë probleme mes veti...Subjektiviteti i tyre juridik, përfundon në momentin e certifikimit...Unë e pash që ju ka l'shu një deklaratë që iks personi, është ëudhëheqë i tyene...Në bazë të c'kahit...

Ne nuk kemi regjistër të këtillë! Ne mbajm regjistra, tha z. Gjoshi, në bazë të rregullores së partive politike. Secili person juridik, themelohet me rastin e lindjes, bile ligji e lejon edhe pak para lindjes...Kurse, personi juridik duhet të jetë i regjistruar pranë një personi kompetent: a OJQ, firmë, biznes, shoqatë humanitare...nuk është me rëndësi...por, me ju dhanë fonde, me administruar fonde, ta dini që jemi në problem...

S'jam duke votuar kundër, të kuptohemi por, është dashur me gjetur një modalitet në financa, sepse atje ja kanë kriju bazën...se, nuk e kanë pasur të qartë se çka janë partitë politike dhe çka janë organizatat e tjera për me ua mundësuar atyre që nuk duan me qenë parti politike...

Ne, tha z. Gjoshi, nuk i detyrojmë me qenë parti politike, por ne është dashur me gjetë një rregullativë...Për shembull, personat që janë themelues me pas një nënshkrim...kujt po ja jep mjetet...në emër të kujt është...Edhe bankat te ne janë problem se si i kanë hapur llogaritë...E kanë hapur një llogari transitore, por ajo ka qenë për një periudhë...Do të thotë, merrni e shikoni...! Nuk po them sot, por mund të përfundoni prapa grilave drejtoresh, nuk kemi bazë ligjore, nuk kemi rregulla...

Adnan Rrustemi: U hapën shumë tema...! Sot, nuk mund të diskutojmë për të gjitha...Për m'u, tha z. Rrustemi, funksioni i KQZ-së është komplet teknik...është zbatues i ligjit për financa politike, sikurse i ka rradhitur subjektet, ashtu si edhe financat...Roli ynë është alokues, dhe nuk besoj që vlejnjë këto që i tha Betimi sepse, statusi

Miradije Meha: është e vërtetë që keni marrë një raport tjetër, raportin e shpenzimeve të buxhetit për tre muajt e fundit të këtij viti. Kur kemi raportu, nuk kemi mundur me i bërë barazimet, se nuk na ka ardhë ende raporti i barazimit prej Ministrisë së Financave - prej Thesarit. Qato barazime, kan reflektu këtë gjendjen k'tu të raportit. Dometha, k'tu tash raportohet, përpara është prezentu vetëm buxheti që o ka për rishikim, jo me k'to ndryshimet q'i janë ba. Tash asht buxheti fillestar, tash a edhe buxheti përfundimtar. Domethanë se buxheti gjatë vitit 2016, njëherë asht aprovu me ligj - buxheti fillestar, pastaj ka ndryshu me rishikim të buxhetit me ligj, edhe dy herë tjera ka n'drru me vendime të Qeverisë. Momenti i parë asht kur na kan dha buxhet shtesë, naj ka dha 221 554 euro, të cilat janë ndarë për paga dhe medijtje, dhe për mallra e shërbime. Momenti i dytë, ka ndodh me vendim të Qeverisë, numri nuk po m'kujtohet, me 28 dhjetor kur Qeveria e ka se ka buxhetin dhe kanë përfundu të gjitha afatet e zotimet e mjeteve, dhe të gjitha procedurat e tjera...

Betim Gjoshi: Të nderuar kolegë, ju kërkoj falje që po e marrë fjalën shpesh, por nuk mundesh me ndejt në këtë institucion pa folë, duarkryq...Por, nuk e lejoj vetën me u ba makinë votimi. Ne, tha z. Gjoshi po flasim për një raport që e kemi të shtypun, dhe po flasim për një raport që e

kemi në imell. Po flasi, konkretisht për një faqe dhe një tabelë, veq gabimeve që ka, për shembull në fq. 3, titulli është "Buxheti i shpenzuar janar -dhjetor 2016", mandej në tekst e keni që në tremujorin e këtij viti KQZ i ka shpenzuar 5 milion e përpjetë, blla - blla - blla, që s'është e vërtetë, sepse si ka shpenzuar këtë tremujor 5 milion...Nuk është e saktë s'i shifer, tha z. Gjoshi, por i ka shpenzuar krejt vitin...

Tabela e fundit, është e ndryshueshme dhe nuk po lidhet kurgja me temën që jeni t'uj folë ju: pasqyra - barazimi, se nuk janë shifrat e shpenzimit të dallueshme, shifrat e planifikimit janë të dallueshme! Ne, nuk kemi tjera buxhete: një në fillim të vitit, dhe një masi rishikohet...mbas tij, as KQZ dhe as Parlamenti nuk ka miratuar kurrëfar buxheti...Në atë, shifrat nuk janë të sakta...!

Kush e ka bërë këtë ndryshim, dhe pse e ka bërë, në emër të kujt...? A duhet ne me qenë kujdestar, mos besuar a mos me besuar...?

Adnan Rrustemi: E qartë, raporti i shpenzimeve bëhet me raportin e planifikimit...jo me...!

Sami Hamiti: ...Kanë mbetë dhe, është një vendim që i bënë brazimet...Nuk mundesh me e heqë prej buxhetit dhe me e qitë në shpenzim, e me thanë m'kanë mbetë...O, s'ke ditë me i shpenzue edhe duhesh me dhanë arsyetim se pse...! Për këtë jem na k'tu, përndryshe është qesharake...! Secilit vjet, ia kishim heqë, i kishim barazu...98, 99% dhe, të gjithë dalin të suksesshëm...Tjetër send është ndarja, ndarja është me kërkesë t'onën, ne, kemi dërgu kërkesë për atë buxhet që na kanë dhënë për zgjedhjet...Por, me i heqë nuk na vesin, na s'kemi kërku me i heqë sepse, është me ligj me i heqë... Janë dy elemente krejtësisht të kundërta...Thuhet "na ka ndryshue gjendja...", jo, jo na kemi kërku buxhet shtesë për Drenasin në bazë të konditave t'ona...prandaj, a na kan pyet kur na i kanë marrë...jo, jo asht ligj, t'i merrë...kur s'i kryen...Prandaj, tha z. Hamiti, ajo pjesë gjithkund qitetet dhe tregohet: thuhet, kjo pjesë ka mbetur e pa shpenzueme, dhe ka shkuar në suficit...Pikë...S'mundesh t'i me thanë...Në format të këtillë unë se votoj sepse, kjo i bjen qesharake, por edhe kundër bindjeve të mia dhe me ma fyer pak intelektin...

Enis Halimi: Në funksion të kontradiktave dhe sqarimit të këtyre dokumenteve, unë propozoj që ta heqim raportin e tremujorit të katërt, dhe të evitojmë cdo paqartësi, ta analizojmë...!

Betim Gjoshi: Nëse e heqim, ne e heqim por, ju nuk na kthyet përgjigje njëherë se,pse është ndryshu, dhe kush e ka ndryshuar...? është mirë me na njoftuar, sepse unë kisha mundur ta votojë duke e besuar se, ky dokument është ai që e kam në imell. Pra, kush ma ka ndrruar dokumentin...?

Enis Halimi: Pikërisht për këtë: pra, të shohim se cka ka ndodh në Sekretariat me këto dokumente, si kanë rrjedhë...!

Adnan Rrustemi: Unë kërkoj mendimin e kryesuesit të Këshillit për Buxhet. Sepse, ne praktikisht ne, as me kërkuar me heqë nga rendi i ditës ne s'kemi të drejtë...

Ilir Gashi: Ne, raportin e shpenzimeve të buxhetit për tremujorin e katërt, si këshill e kemi

trajtuar...Një javë më herët...aktualisht, nuk mund të them nëse rrugës deri këtu është ndryshu, apo është ky raport që e kemi miratuar në këshill...Pra, kjo kërkon sqarim...

Adnan Rrustemi: Raportin, e kemi marrë para tri ditësh... Ky raport, është i lidhur edhe me raportin që e kemi tani, fati i këtij varet edhe nga dokumenti i radhës...

Sami Hamiti: Problemi, është i thjeshtë: konditat nuk ndërrojnë...S'është Sekretariati dhe KQZ që mund t'i ndërrojnë...Problemi është: rishikimi i buxhetit një, tjetra, dy, me kërkesë të zgjedhjeve të Jashtëzakonshme në Drenas - Qeveria ka marrë vendim dhe i ka ndarë do mжете...Pjesën tjetër, ke me e pasqyruar suficit, s'ka vendime këtu...nuk mund të dilet jashtë kësaj, merreni pasqyrojeni... Prejt kujt e fshehni, atje të tregojnë çka keni suficit...Auditori, po ashtu se fsheh, e pasqyron si mosdiqe e shpenzimeve, ka me ta pasqyruar si suficit...

Adnan Rrustemi: Kjo është skandaloze për besë, është njëfar tentimi për me t'mashtru...! Brenda një muaji, del se janë shpenzuar mjetetet, e ne para pak muji, kemi patur as 40% të buxhetit të paharxhuar...Tani, na dalin 98% të harxhueme...

Sami Hamiti: Po, ky është mashtrim...Në raport, duhet të paraqiten dhe të tregohen...Në ministri, ua tregojnë se ua marrin...Por, ne duam të dim se pse s'janë harxhue 230 mijë euro...? Unë, po due në strukturë arsyetimet, jo në formë...Raport pune dua: ku, pse, qysh nuk janë harxhue, kush është fajtor, pse s'jan harxhue...?

Betim Gjoshi: Ka qenë minimale të na njoftoni...Në raport, veq gabimeve narrative, nëse po na ndëgjoni, ti drejtoresh, kryeshef...Ka gjëra që ju mungojnë dhe nuk janë pasqyruar në raport: te plani i prokurimit që ne na ka ardhur në raport: për shembull, e keni një furnizim për inventar në vlerë prej: 28 385. 19 euro..Unë kam qenë kundër se, ju kam tregue që ka me ju mbetë borgj...! Në pasqyra financiare, nuk është pasqyruar...As për këtë vit, nuk e keni lënë si borgj, domethënë askund nuk figuron...Ky, nuk është investim i vogël, por që askund nuk është pasqyruar...Pra, si me ju besue që s'jan "harrue" edhe investime të tjera, më të vogla...

Nëse ju mungon një shifër e tillë, i ndërroni tabelat...! Si me ju besue...? dy tabela, është dashur të jenë...

Adnan Rrustemi: Po, mendoj që duhet të shtyhet nëmbledhjen tjetër...

Barjam Ljatifi: Tash ne, po themi se, çka duhet të bëjmë...! Kryesuesi i këshillit, duhet të na tregoj se çka të bëjmë...çka më tutje...të kthehet në administratë, pastaj në këshill...!

Ilir Gashi: Po na përcjellë çështja e trajtimit të shpejtë të dokumenteve, pastaj kamufliimi edhe mund të jetë i mundshëm...pra, deri aty ku dikush e kupton më mirë dokumentin, qëllimet, pse...? Le të kthehet në Sekretariat, dhe le të vijë drejtpërdrejtë në KQZ.

Adnan Rrustemi: është mirë ta kemi qysh nesër këtë material. Pra, ta kthejmë për përmirësime.

Sami Hamiti: Le të përmirësohet, dhe silleni nesër. Uluni bashkarisht, edhe me auditorin dhe,

silleni si duhet...

Betim Gjoshi: Problemi është që, këta duhet me na njoftue kur bëhen ndryshime, s'është njoftuar as kryesuesi, as ne...! As kërkimfalje s'ka...

Adnan Rrustemi: Jam kundër apsolutisht, të kthehen të dy dokumentet mprapa, është lëshim i madh ky, s'kemi cka të diskutojmë...të plotësohen në bazë të kërkesave të bëra...të hartohen dhe plotësohen në përputhje me buxhetin e tërësishëm...Si KQZ, kemi nevojë me ditë sa ka qenë buxheti vjetor mbas dy rishikimeve, dhe a është shpenzuar në përputhje me buxhetin...Unë, ne, kemi përgjegjësi me e ditë...në raport me institucionet e tjera, ajo tjetër çështje...

Betim Gjoshi: Unë kisha një kërkesë që s'mora përgjigje: ju thash se, komplet çështja e mobileve, e inventarit nuk figuron askund...! A di dikush me tregue se, ku është paraparë në raport, përndryshe mirëmbajtjen e zyreve e keni parapa si borgj, po këtë se keni paraparë askund...

Miradije Meha: Në shifra, nuk mundet me ndërru kurgja, pse s'asht shpenzue buxheti duhet ba n'i raport të veçanta dhe me than se pse s'asht shpenzu, por sa i përketë këtij raporti financiar, pasqyra financiare është e njejtë, kurse në raportin e shpenzimeve ka çka me diskutue...

Për mobile, ato janë ardhë në vitin 2017, dhe pranimi teknik i tyre ende nuk a ba...! Tash, ne nuk e kemi ba pagesen se, nuk e kemi llogaritë si obligim të vitit t'kaluem...Kurse, renovimin e zyrave e kami pasqyru...

Sami Hamiti: Ai, raport vjetor - nuk është raport vjetor, janë pasyra...Në raport, duhet me tregue se cka ka ndodh, pse ka ndodh, duhet me i dhënë krahasimet, por edhe formati, edhe brendia nuk janë raport...T'i, duhet me tregue se, qysh ka mbetë suficiti...mos bëni hajgare me ne...!

Betim Gjoshi: Raportin, jam me e shqyrtuar sot, dhe mund ta shohim se ku jemi...! Po e lam për nesër, kemi me pas prapë konfuzion, problem...

Adnan Rrustemi: E kam edhe një kërkesë: raportin e punës, nuk kemi interes me e shqyrtu në aspekt teknik, ne s'mund të ndalemi faqe për faqe, por ne kemi arsye me ditë se çka asht realizu në 2016, çka nuk është realizu dhe, çka po mbetet për 2017...

Adnan Rrustemi: Unë, propozoj që nesër të vazhdojmë prej ores 10:00 sepse, kam nevojë për ta shqyrtuar planin, sepse edhe raporti është i ndërlidhur...

Sami Hamiti: Nëse nesër s'ka përmirësime, unë se votoj...

Vazhdim i mbledhjes së KOZ -së, nr.2/2017

Pjesa e II. Datë: 31.01.2017

Ora: 10:30

Prezentë në mbledhje: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

1. Hyrje

Vazhdimi i pjesës së dytë të mbledhjes, është kryesuar nga Adnan Rustemi, anëtar i KQZ-së.

Adnan Rustemi: Kemi kuorum, po fillojmë me vazhdimin e mbledhjes nr. 2, me rendin e ditës pothuajse me rend të njëjët. Prandaj, vazhdojmë aty ku kemi mbetur, në fakt tek rekomandimet e Këshillit për Buxhet dhe Financa pas rikthimit për ndryshim dhe plotësim të Raportit Vjetor Financiar dhe Raportit të Shpenzimeve. A ka mbajtur mbledhje këshilli...?

Eshref Vishi: Dje në komision, u vendos që materiali të kthehet në administratë, të përmirësohet por pa këshill, dhe të sillet në mbledhje...

Adnan Rustemi: Kush do na japë shpjegime...?

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor Financiar i vitit 2016

Enis Halimi: Që të mos ju lodhim, dhe për prezantim të shifrave në detaje, e ftoj drejtoreshen që t'i japë shpjegimet e nevojshme...

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP -it, tha se Raporti Vjetor Financiar, është format standard që e ka kriju Ministria e Financave, dhe në bazë të Rregullores 01/2017, e aprovuar këtë vit me të cilën na kanë informuar më 20 janar. është formë, me të cilën informojnë të gjitha organizatat buxhetore. Me ministrinë e Financave, jemi barazuar me 24 janar të këtij viti, kemi pas afatin e shkurtër, por raporti ka qenë edhe dje para jush, me ndryshimet e përmirësuara.

Betim Gjoshi: Jemi duke folur për raportin që, s'ka pësuar ndryshime.

Miradije Meha: I kemi bërë ndryshimet në fq. 8, të cilat i kemi dërguar dje...Ndryshimet, i kemi përmirësuar...Buxheti final, ka qenë me ligj, plus buxheti i ndarë për zgjedhjet e Drenasit,

buxheti final ka qenë 5 milion e 65196 euro. Nga ky buxhet, i kemi krahasuar shpenzimet për këtë periudhë. Pra, buxheti i shpenzuar ka qenë 5 milion 369 42 euro. Pra, del shpenzimi real i krahasuar. Buxheti me rishikim, dhe me kërkesë të KQZ-së nuk është shpenzuar i tëri, dhe kanë mbetur pa shpenzuar 281 153 euro dhe që këto para, janë marrë nga Qeveria më vendim të datës 28 dhjetor, 2016. Kurse, në kategorinë e komunalive dhe të shërbime dhe mallra kanë mbetur pa shpenzara 28 804 euro, drejtpërdrejt kanë shkuar në suficit. Ky është sqarimi - plotësimi. Buxheti në krahasim dhe final, është shpenzuar 59.1%.

Betim Gjoshi: Kam disa vërejtje: në fq. 20, kanë mbetur shifrat jo mirë teknikisht. Janë disa vërejtje - gabime. Te pagat, kanë mbetur pa shpenzuar 12 544 euro, fq. 19.

Miradije Meha: Jo, këto janë të buxhetit shtesë, dhe te paga Qeveria nuk ka marrë asnjë euro.

Betim Gjoshi: Borgjet që kanë mbetë: Ka borgje më shumë se që janë prezentuar. Te raportet për gjendjen e zbatimit të auditorit, ky nuk është i azhurnuem. Ky, nuk është i fundit, është version i mëhershëm...Ju, duhet të jepni garanci se këto pasqyra financiare, janë të sakta! Por, edhe shpjegime të duhura...

Sami Hamiti: Shumica e kërkesave që ishin dje të paraitura në mbledhje, janë paraqitë në raport. Këto, janë pasqyra financiare...si terminologji. Ligji për Financa Publike, saktë e parasheh çka duhet me raportue në tremujorë (rrjedhat, obligimet, sa janë paguar, sa janë...?), dhe në gjashtëmujorë. S'janë këtu, ju e dini...! Kërkesat, saktë janë të definuara në ligj. Te pjesa e raportimit, te projektet...shpjegohet qartë rrjedha - procedura e zhvillimit...

Një standard, duhet të vendoset me ligj: është llogaridhënje e juaj, është me ligj, ka mostra sa të duash... Këtu, s'ka transparencë...raportoni me ligj...

Mriadije Meha: Borgjet, i kemi më të mëdha se që i kemi prezentuar prej 79 000 euro. Malli ka ardhur kët ëvit, dhe ende procedurat nuk janë kryer...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Raportin Vjetor Financiar të KQZ-së, me vota unanime.

Adnan Rrustemi: Vazhdojmë me pikën e radhës.

3.Shyqrtimi dhe miratimi i Raportit të Buxhetit dhe i Shpenzimeve për vitin 2016

Liridon Nika, zyrtar për Financa, tha se ky është raporti i buxhetit dhe shpenzimeve, është tremujori i 4, por këtu përfshihet komplet viti. Këtu, janë bërë ndryshime teknike, por e keni pas më herët...Buxheti përfundimtar, ka ndryshuar me ndëryhrjet e djeshme, ndryshimet praqiten në fq. 4. Ai, dha një pasqyrë të shpenzimeve në kategoritë e ndryshme shpenzuese...

Betim Gjoshi: Sot, kemi një qartësi të raportit... Buxheti ynë, është 81, 82% i shpenzuar. Te buxheti i zgjedhjeve, është 72.4%. Te dyjat bashkë, janë 75% të buxhetit të shpenzuar. Në bazë

të raportit...janë shpenzu mjetet, por te projektet del që nuk ka pas buxhet...!

Kam thënë edhe më heret se, disa projekte nuk mund të realizohen. Pra, edhe kërkesa për zgjedhjet në Drenas, ka qenë e tepërt sepse, kemi patur mjete. Tani, del që na kan tepruar...

4. Raporti mbi zbatimin e Planit të Punës dhe aktivitetet e tjera për vitin 2016

Adnan Rrustemi: A ka dikush të shtojë, të flasë...?

Betim Gjoshi: Nëse ka më shumë, le të fletë dikush por, e kemi lexuar dhe të mos ndalemi shumë...!

Eshref Vishi: Të mos ndalemi shumë te raporti i punës 2016, por është i rëndësishëm një raport i kryeshefit, por më shumë të fokusohemi te plani 2017.

Adnan Rrustemi: Ta kemi një raport, më shumë se si kryeshefi e sheh punën e Sekretariatit gjatë vitit 2016.

Enis Halimi: Para jush, keni raportin e punës 2016, dhe aktivitetet e parapara 2016. Ky plan, ka qenë një praktikë e re, e vendosur pas miratimit të dokumentit strategjik. Si i këtillë, ne mendonim se, do të mund të bënim më shumë. Mirëpo, gjatë rrugës së zbatimit, plani ka qenë ambicioz, dhe te disa aktivitete, kemi ngecur.

Dsia aktivitete, janë realizuar, tha z. Halimi, por kemi mungesë në shpërfaqje të punës, por edhe neglizhencë. Raporti, përmbanë realizimin e punëve, por disa aktiviteteteve mendojmë që këtë vit, ti realizojmë...! Për shembull, hartimi i koncept - projekteve, koncept - dokumenteve që kanë të bëjnë me projektet e caktuara...Kemi nxjerrë mjete që, ti buxhetojmë projektet gjatë këtij viti, por plani ka qenë ambicioz por, ky ishte një plan mbas planit strategjik dhe, jemi gjendur edhe në situata të pavolitshme...

Konsideroj, tha z. Halimi, kemi bërë punë të mirë, porse kemi mundur ndoshta të bëjmë edhe më shumë, por aktivitetet si të këtilla, janë të ndërlydhura nga koncept - projektet e buxhetuara dhe ne, e kemi bidnur ministrinë se ne, do realizojmë projektet zgjedhore...Propozim plani, përmbanë objektiva të filluara në 2016, por që besojmë thellë t'i realizojmë këtë vit. Edhe raporti, edhe plani i punës janë në harmoni, dhe besojmë t'i realizojmë këto objektiva...

Betim Gjoshi: Kur është emiratuar plani i punës, kam qenë i bindur se ka me ngecë sepse, ka qenë ambicioz, dhe në disharmoni me kapacitetet profesionale...Raportin, nuk është mirë me e ngatërruar me raportin e punës për Kuvend. Nga 78 aktivitete, shoh se ato janë të shkruara qartë. Detyrat ligjore, janë plotësuar. Ju s'mund t'i bartni projektet, sepse ne mund edhe të mos i miratojmë! Disa punë, janë obligime, detyra dhe ju, s'keni qare pa i bërë. Por, edhe veq 10 projekte me qenë, kur realizohen, nuk është pak...! Lista votuese, është projekt që është kryer mirë, kurse raporti i punës është bërë, por nevet s'na është prezantuar...Dizajnet e formularëve, janë

të njejët që prej vitit 2007, pavarësisht si është punuar...Rishikimi i procedurave të QNR-së, edhe këto janë kthyer, dhe s'na janë sjellë ma...! Vlerësimi për themelimin e QV-ve, është një projekt që është kryer mirë...Projekti për të verbër, është kryer por, s'është kryer informimi publik...Ka edhe tjera punë që s'janë kryer...

Në vazhdim, z. Gjoshi, analizoi, zbërtheu, si dhe paraqiti vërejtjet për të gjitha pikat e planit.

Adnan Rrustemi: Nuk mundemi të i analizojmë të gjitha detyrat, sepse zgjatemi shumë, mirëpo ne ishte dashur ta kemi edhe planin e vitit të kaluar, në mënyrë që ta krahasojmë raportit. Por, unë po bëjë një analizë përgjithësuese: ka pasur aktivitete ditore, javore e mujore, por që nuk janë faturuar si performancë e institucionit, e që as nuk kanë qenë në planin e punës! Punë e funksionimit të institucionit. Në përgjithësi, në raport vërehen dy aspekte: ato projekte që janë realizuar, sidomos në bashkëpunim me IFES-in, kanë pasur performancë të mirë. Mirëpo, janë së paku 5 tipare të dallueshme të stafit: mungesa e iniciativës së stafit, për shembull, hartimi apo rishikimi i procedurave të QNR-së. Asnjëherë, nuk kanë ardhur në KQZ...! Ka qenë në planë të punës, është dashur të vijë në KQZ. Pra, edhe në këtë vit, mendoj që mund t'i rishikojmë...! Ka, nevojë.

Ka mungesë konsistente në aktivitet, edhe kur ka iniciativë: për shembull, rasti i formularve, i strategjisë, i nxjerrjes së të dhënave krahasuese nga publikimet për pjesmarrje në zgjedhje, pastaj iniciativat për doracaktët, formularët etj.

Mungesa e buxhetit: po, është karakteristikë e renditjes së projekteve, por pa e menagjuar si duhet anën buxhetore. Pra, ka pas mjete, por s'janë menaxhuar projektet si duhet!

Mungesa e seriozitetit të duhur: për shembull trajnimit. S'kemi raport se, si është realizuar ky aktivitet.

Mungesa e kapaciteteve profesionale, si në planin e punës dhe në aktivitete....

Pra, nuk kemi pasur aktivitete thelbësore, as nga QNR, as nga terreni, as nga trajnimet, por as nga informimi publik. Sidomos nga informimi publik, s'kemi pasur asnjë informatë dhe ne, vazhdojmë ta kemi informimin, si në 2007...!

Sami Hamiti: Elementi i parë, që e tha edhe Betimi, është se raporti, është përshkruar. Pastaj, projektet...! Ne, kemi pasur edhe një raport të auditimit për një pjesë të projekteve...dhe, kemi parë se kur është IFES-i, punët shkojnë mirë, madje edhe auditori e kryen punën më mirë sesa, që arrinë t'i merrë informacionet në Sekretariat.

Plani i Prokurimit 2016...!? Këtu, i keni listu kontratat e prokurimit. Prej 30 aktiviteteve të prokurimit, 25 janë në muajin e 11 dhe 12. Deri në muajin e 7, janë vetëm 4 aktivitete të prokurimit.

Këtu, s'ka implementim të planit, por vetëm i keni listuar. Për 6 muaj janë bërë 3 aktivitete, pra

njësitë kërkuese nuk kanë afruar asgjë...Unë jam i rezervuar, prandaj nuk do ta votoj.

Eshref Vishi: Nuk jam i kënaqur me formën e cila po na prezantohet...Nuk do të ndalem te përgjegjësitë ligjore që ka institucioni për raportim brenda institucionit dhe jashtë institucionit, ato janë kategori ligjore dhe, s'kemi qare pa raportuar. Pra, raportimi, është kategori ligjore. Plani i punës për vitin 2016, sipas asaj që është raportuar, pjesërisht është realizuar. Një pjesë e aktiviteteve, janë ngelur në procedurë e sipër, një pjesë pasqyrohen si të pa konkretizuar. Si duket, nuk ka qenë plan i harmonizuar me kapacitetet kadrovike dhe materiale. Pse po e them kë të ? Pa kë to dy komponenta, çdo planifikim është i destinuar të dështojë . Administrata ka ngecë , edhe në përcjelljen e zbatimit të aktiviteteve. Po për mend aktivitetin 12, dhe 13. z. Vishaj, i zbë rtheu si shembuj të ngecjes së zbatimit kë to dy aktivitete. Përpjekjet, ai i konsideroi vetë m si pë rpkje, por jo edhe si rezultate të zbatimit të planit.

Binak Vishaj: Kryesues, une shkurt..., ma shumë e kam n'i pyetje...Sa përqind është realizu plani i punës 2016, pra, d'u me ditën se KQZ sa përqind ka m'ri me realizu kë t plan, jo për kurgja tjetër, po t'pakten për me ditë - aktivitetin që e kem pas, planin e 2017-es, cilat aktivitete s'jan nis fare, cilat aktivitete janë bart n'2017, e që janë nis n'2016...? Edhe, për çka..., domethënë janë përsëritë për tri vite me radhë ...? Ka aktivitete që janë qe tri vjet dhe që , mujn m'u për rsië rtië n'plan t'puns...! Kjo asht, po m'intereson m'u: sa asht përqindja e realizimit t'planit t'puns 2016 ?

Adnan Rrustemi: A keni bërë llogaritjet t'aktiviteteve...?

Enis Halimi: Asht problem me kuantifikim me pë rbindje, sepse jo krejt aktivitetet janë të së njejtë s natyrë , disa aktivitete i kemi obligim ligjor, disa janë n'hartim, disa janë në procedurë të koncepteve, disa janë në zbatim...!

Betim Gjoshi: Nuk shkon në 80%, realizimi i planit...Një vë rejtje në fq. 40, pika 73..."Rishikim i rregullores...", follet për një puntori të OSBE-së , kushedi si ka mbetë ...! në 75, e keni...Nuk është shkruar asgjë për rishikim të rregullores, shikojeni..

Eshref Vishi: Aktivitet për aktivitet...a, janë të realizuara apo jo, mua më dalin që jo...!

Binak Vishaj: Unë , nuk kërkova pjesë nga aktivitetet ligjore, sepse ato janë punë e përgjegjësis...thash, për projektet që kanë buru prej një sive tona...! Për 2017, duam me ditë sa keni qenë produktiv...

Ilir Gashi: Ky raport, asht ajo çka ka ndodh gjatë vitit, por pasojat janë më shumë çështje e kohës, sepse edhe ne si KQZ, po lejojmë me futë projekte që janë përtej kapaciteteve profesionale të realizueshme. Konsideroj që për secilin propozim - projekt, do të duhej që secila një si kërkues që ka paraqitë projekt, të shpjegojë se si mund të realizohet projekti, dhe të merret përgjegjësia e kërkuesit...Pra, në se s'realizohet, në fund të vitit dikush duhet me dhanë përgjegjësi...

Një projekt, ose është në tentativë për t'u kryer, ose s'është ..., Nuk ka: është krye, s'është krye, tha z. Gashi. Kjo, është e matshme: nëse kanë qenë 70, dihet shumë mirë, janë krye po e zëmë, 50...Janë krye, s'janë krye...dihet qartë cila është krye, cila s'është kryer dhe, kjo është e matshme...

Të mos lejojmë të fusim në plan projekte, e të cilat në fund të vitit 2017 dalin që s'kan mundur të kryhen...

Adnan Rrustemi: Iliri kërkoi me e ditë se si zyrtarët, kanë me e realizuar projektin..., po t'i ke zyrtar që nuk rendisin fare projekte, përtej atyre obligative...Ne, duhet të bëjmë një balans të asaj çka është e realizueshme, dhe cka nuk është ..! Mirë po, ne duhet të ecim përpara si institucion...

Po pyes: a ka dikush diçka për raportin e punës...?

Eshref Vishi: Dua të mbështetem te kapacitetet, mirë po këta të Sekretariatit, duhet me i ndez motorat, me ecë përpara...

Ilir Gashi: Ideja ishte e mirë, por jo që ne t'ia përshtatim kapacitetet planit, mirë po më mirë është me i ofro 5 objektiva e me i realizu, e jo me i ofro 10, e mos me i realizuar as 3 projekte...

Të fokusohemi në atë që mundemi, tha z. Gashi.

Bujar Basha: (OSBE): Sa u përketë projekteve që janë të mbështetura nga OSBE, informacionet janë të mangëta, por ne mund t'ua dërgojmë edhe rekomandimet që kanë dal si rrjedhojë e aktiviteteve që ne i kemi mbështetur.

Adnan Rrustemi: Pajtohem që ju t'i dërgoni rekomandimet e rëndësishme për institucionin tonë.

Po e hedhi në votim raportin: 3, 6, 8 anëtarë...Kush është për..?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin mbi zbatimin e Planit të Punës dhe aktivitetet e tjera për vitin 2016, me 2 abstenime (Sami Hamiti dhe Betim Gjoshi), dhe 6 vota për!

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Planit të Punës dhe aktivitetet e tjera për vitin 2017

Anëtarët e KQZ, lidhur me këto pikë të rendit të ditës, hezituan që t'i qasen fillimisht për shkak të vërejtjeve, adresimit të problemeve, kritereve, sistemimit etj.

Betim Gjoshi: Ne, megjithatë po e fillojmë diskutimin. Në draft, e kemi një listë të aktiviteteve, dhe mund t'i japim formë planit...Por, ne duhet të diskutojmë se a janë këto 69 aktivitete, por prej tyre, veq 16 aktivitete, të tjerat, 52 janë detyra që patjetër duhet me i

b'a...! Sepse, kë to i ka përcaktuar ligji, për shembull hartimi i planit të buxhetit, i prokurimit etj. Ndarja e objektivave, buxheti, dhe a është plani i përfshirë me të gjithë sektorë të brenda planit...

Në kë to 16 projekte, 2 nuk i kam kuptuar: 54, dhe 58...! Pra, planin duhet të na e sillni të qartë, të organizuar...Tjetra, krejt plani i punës, nuk përfshinë asnjë projekt për Zyrtarë të Komunal Zgjedhor, por edhe për disa sektorë të brendshëm...! Projektet e OSBE-së, nuk janë përfshirë, nëse ata kanë ndonjë projekt...

Adnan Rrustemi: Si po thuhet, veq atyre projekteve që janë obligime ligjore, në parim nuk po i kontestoj, çështja është se sa janë gjithë përfshirë se. Pra, në situatën që jemi, nuk e di edhe se çka mungon... Por, edhe nga ajo se vitin e kaluar nuk janë realizuar disa projekte, Rishikimi i Procedurave të QNR-së, mendoj se duhet të përfshihet. Pra, kjo është për rritje të sigurisë...Po ashtu, për Votuesit e Rinjë, duhet të ketë projekt sepse, kë të vit e kemi edhe vit zgjedhor. Doracaku i trajnimit, dhe atë në tremujorin e parë se, nuk duhet të shkojë më tutje...Rishikimi i Formave, po ashtu duhet me u bartë sa më shpejtë në tremujorin e parë...

Zhvillimi i Programit të "E - Mësimit", mendoj që është i domosdoshëm, tha z. Rrustemi. Sepse, kjo mundëson efikasitetin për shumë kategori që janë të përfshirë në zgjedhje.

Miratimi i Integruar i Planit të Sigurisë, po ashtu, mendoj që duhet të jetë një projekt që duhet të hyjë në plan...Ky, është një plan serioz, dhe që duhet të jetë tamam plani i sigurisë, e që përfshinë të gjitha palët. Ky plan, nuk më është dukur i duhur, e aq më pak që të jetë vetëm punë e një zyrtari..

Një trajnim për ZRPP-në për çështjet që kanë të bëjnë me partitë politike, ngase ekziston një qasje e ngurtë...Ideja është me ngritje nivelin e partive politike në ZRPP. Pra, një trajnim të nivelit të duhur...

Ne, ishte dashur që t'i bëjmë edhe do analiza për zgjedhjet e Drenasit, sepse ishin zgjedhje të shpejta, e për ne ishin zgjedhje sfiduese, pra një analizë se, si kemi reaguar ne, sa kemi arritur t'i kryejmë detyrat tona...

Sami Hamiti: Hartimi i planit të buxhetit 2017, 18, 19, 20...E keni kaluar kornizën, vjet e keni pas 2016, 2017, duhet me qenë 2018, prapë hartojeni, quajeni si të doni...Implementimi, shikojeni në shkrim se çka keni shkruar...Se bë në KQZ implementimin, po e bë në Sekretariat...E keni, 2016 dhe kjo i bjen që veq e keni kopjuar dhe e keni qitur, në 2017. Hiqni përshkrimet, hiqni raportin 9 mujor, sepse e keni raportin vjetor në bazë të nenit 46... Me nenin 42, ju obligon me pas raport në çdo tre muaj...Hiqeni nëntmujorshin...

Në çdo vend e shoh që nuk është deklarata e Kryeshefit, e në raporte keni me tregu a keni deficit, suficit...! Kjo kë shtu, është keq...

Eshref Vishi: Plani i punë s nuk i paraqet kushtet, konditat që ne të punojmë këtu...Po përsëriteni, por ne nuk dim për kostot financiare, nuk ka numra askund në kuptim të mbulimit buxhetor...KQZ, ka projekte që mbështeten nga partnerë t tanë , pra ne duhet sakt me e ditë ...pra, cilat projekte do të mbështeten...

Aktivitetet, duhet të paraqiten saktë , konkret, e po ashtu edhe afatet kohore duhet me u paraqitur saktësisht...Rubrika, e të dhënave është e zbrazë t...Kjo, mua më shtynë që kë të plan si të kë tillë , nuk mund ta diskutojmë ...

Binak Vishaj: Për 2017, e kemi kë tu edhe OSBE-në , dhe nuk e dim a kemi ndonjë projekt që e implementojmë bashkë ...E përkrahi diskutimin e kolegë ve që , të bë het hartimi i projekteve në bazë të renditjes: pra, të gjitha projektet që shkojnë për zgjedhjet, të hartohen në pjesë n e parë të planit...

Adnan Rrustemi: Po, mungon një listim i operacione zgjedhore, i projekteve që kanë të bë një me proceset zgjedhore...Po, edhe aktivitetet që i bë jmë me partner, duhet t'i dim...

Enis Halimi: E kemi zgjedhë kë të format të planit për t'ua prezntuar në më nyrë që të jetë më i lehtë , më i thjeshtë për t'u kuptuar...Ne, e kemi edhe një format që e kemi menduar, ka të bë jë më planin e veprimit i cili, në detaje parashikon se kush, cka duhet t ë veprojë , e po ashtu, janë edhe objektivat...Pra, e kemi një plan - në nveprues...

Edhe te plani i prokurimit, të gjitha aktivitetet pothuajse janë projekte që kanë të bë një me zgjedhjet dhe, ato, do të zhvillohen menjë herë , aspekti prokurues, tenderues, pra, në pjesë n e parë të vitit në më nyrë që zgjedhjet t'i presim në qetë si...

Ercan Spat: Në se më lejoni, këtu është ba vë shtirë me disku...Dëgjova kolegët, sa vërejtje, gati deri te falcifikimet, dëgjova pyetjet që u bë në , e s'ka asnjë pë rgjigje...Për kë të plan, unë as në parim nuk do të votojë ...

Sami Hamiti: Po e përsërisë , mos fusni projkete që nuk kanë orientime se nga ka me ardhur kostoja financiare...Pastaj, kë të vit trendi, është tjetër...Plani, duhet të marrë formë n e duhur që , duhet ta votojmë ...

Illir Gashi: E thash se, nuk ka më të rëndësishme se zgjedhjet që kemi për t'i mbajt në fund të vitit, dhe mendoj se, ky plan duhet të jetë direkt në funksion të zgjedhjeve që i kemi...Tash, nuk kemi kohë për projekte të tjera...

Difektet që na kanë përcjellë, është primare të analizohen dhe të shihen, pra kë tu duhet të fokusohemi...por, ne duhet të kemi synim vetë m zgjedhjet që na presin në vjeshtë ...

Betim Gjoshi: Ta kemi një far konkluzioni, plani nuk ë shtë hartuar si duhet, i mungon narracioni, arsyeshmëria, struktura, buxheti...Projektet që u propozuan nga Adnani, mos i fusni në plan në se nuk mund t'i zbatoni...

Adnan Rrustemi: Ne, po e kthejmë planin për ndryshim, në përputhje edhe me propozimet që u bë në deri më tani...

Vazhdim i mbledhjes së KQZ -së, nr.2/2017

Pjesa e III. Datë: 07.02.2017

Ora: 13:30

Prezentë në mbledhje: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

1. Hyrje

Vazhdimi i pjesës së tretë të mbledhjes, është kryesuar nga znj. Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

2. Propozim - Plani i Punës 2017 i KQZ-së

Enis Halimi: Para vetes kemi planin me ide dhe propozime që kanë rrjedhur, pas shqyrtimit në mbledhjen e kaluar. Janë dhënë edhe vërejtjet që administrata i ka përmbledhur në dokument, ashtu si edhe kostoja. Aktivitetet ligjore s'i kemi lëvizur, kurse projektet e tjera - aktivitetet i kemi përqëndruar në kuptim të zgjedhjeve për të qenë ato sa më të mirë organizuara. Nuk e kemi planin lidhur me sigurinë, teknikisht ka rënë...Dhe mendoj se është i gatshëm për shqyrtim dhe miratim.

Eshref Vishi: Kryeshefi po thotë se, janë përmbledhë propozimet që i kemi bërë. Unë po them që, të jenë përfillë dhe se, këto aktivitete shumica kanë të bëjnë me zgjedhjet. Administrata, ka

sjellë planin më duket, pak më mirë...Mendoj që të shkojmë me radhë për shqyrtim...

Binak Vishaj: Propozimi i Eshrefit, mendoj se na ngadalëson. Ne e kemi pas planin, e ne mund t'i diskutojmë vetëm ato pika që janë të diskutueshme, por jo një nga një. Pra, unë jam për dhe të diskutohet ajo që dikush, kërkon të diskutohet...

Eshref Vishi: Ky, është një propozim imi...

Bajram Ljatifi: Do t'isha i lumtur sikur të jenë inkorporuar propozimet e tona. Pra, nuk e di nëse jemi në gjendje t'i shohim ato ndryshime që i kemi kërkuar...

Enis Halimi: Janë përfshirë vërejtjet, propozimet dhe kërkesat e tjera. Plani, i ka përfshirë të gjitha propozimet, e po ashtu i ka edhe afatet kohore, koston e shpenzimeve. Edhe planin e Integritetit të Sigurisë që ka rënë teknikisht, do ta inkorporojmë.

Eshref Vishi: Kam vërejtje tek shtylla strategjike - korniza ligjore: I kemi tri aktivitete, dhe lidhur me këtë, do t'ishte mirë ta kemi një aktivitet dhe të rishikohen të tri rregulloret, dhe nëse kemi edhe ndonjë aktvendim, pra, të mos kufizohemi në këto triat...Pra, të bëhet një punëtori, dhe..., edhe tek çështja e raportimeve...! Ju keni thënë raportime katër mujorë, kjo të dizajnohet dhe të jetë raportim tremujor sepse, është edhe vit zgjedhor.

Sami Hamiti: S'ka raportim tremujor...! Ligji e përcakton, e po ashtu, edhe sa herë që kërkon KQZ, duhet të raportoni..

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Planin e Punës 2017 me vota unanime

3.Raportet e Këshillave të KQZ

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit

Eshref Vishi: është çështje e administratës për referim, meqë ka qenë në diskutim ky plan.

Enis Halimi: është derivat i planit të punës për ato çështje për të cilat nevojitet të zhvillohet aktiviteti i prokurimit. Plani, i përmban të gjitha aktivitetet tenderuese në funksion të përmbushjes së aktiviteteve qoftë zgjedhore, dhe qoftë jo zgjedhore. Gjatë shqyrtimit të kaluar, është kërkuar që ky plan ta ketë edhe pjesën narrative, afatet kohore, dhe kjo është bërë...

është vetëm një ndryshim, tha z. Halimi, te sigurimi kasko i automjeteve. E keni ndryshimin... Aktivitete tjera, i kemi planifikuar ti zhvillojmë pra se të ndodh aktiviteti zgjedhor dhe, kjo do të na i lehtësoj punët.

Betim Gjoshi: Te zgjedhjet, ka shumë aktivitete dhe nuk janë parapa të zhvillohen në kohën e

zgjedhjeve, te informimi publik, po edhe të tjera që mund të kryhen më herët...Unë, pash aktivitete që janë krye në janar, e ne jemi në shkurt duke e miratuar planin..., pra, s' kan mund të kryhen, dhe kjo s'ka kuptim...Po e përmendi sigurimin e automjeteve, aty ku u tha se janë bërë ndryshime në shumën e pagesave...

Bajram Ljatifi: Në plan, unë nuk e kam parë nëse, do të kemi një parking. është dashur të futet kjo në plan...Kjo na duhet, është dashur të bëhet përpara...

Enis Halimi: Për parking për periudha zgjedhore, ky është një problem.. Nuk kemi as në afërsi, objekte ku mund të parkohen veturat.

Valdete Daka: E kam një pyetje, se m'u duk shumë enorme për transport të stafit në QNR: 17 000 euro. Qysh...?

Enis Halimi: Secilën shifër, e kemi diskutuar. Përafërsisht, kaç kan kushtuar edhe në zgjedhjet e kaluara. Në QNR, punojnë disa ditë qindra persona. E kemi diskutuar secilën shifër në mënyrë precize.

Sami Hamiti: Dërgesa brenda vendit - dërgesa postare: 90 000 euro.

Enis Halimi: Votimi jashtë vendit, na bënë që ne të jemi të përgatitur. Ndoshta që ne t'i kemi ndoshta vetëm dy mijë zarfa, mirëpo sikurse na ka ndodh në 2013, na është dashur ti përcjellë me dhjetëra mijëra zarfe...Numri i atyre që mund të votojnë, është i vështirë të parashikohet...

Valdete Daka: Edhe inventari...! Kjo, thua se s'ka përfundim. Ne çdo vjet blejmë inventar. Për kend...?

Enis Halimi: është kërkesë e njësisë kërkuese për QNR. Kërkesa, është në funksion të punës së stafit të QNR-së. Si e këtillë, është paraqitë.

Valdete Daka: Po, ama, arsyeshmëria...! As këto që i kemi këtu në sallë, nuk na duhen...!Një pjesë e karrikeve që i kemi patur, kan shkuar në QNR.

Sami Hamiti: Kërkesa, është për 300 karrike. M'u duk, e tepërt...! A janë duke u ndërruar të gjitha, sa persona mund të jenë në të njëjtën kohë në QNR. A janë duke u ndërruar të gjitha karriket, a janë t'u u duplifiku...

Enis Halimi: është proces i paparashikueshëm, sepse nuk e dim sa komuna shkojnë në balotazh, sa organizata vëzhguese do t'shprehin interesim, sa vijnë...! Njësia kërkuese, në bazë të nevojave të veta, e ka bërë kërkesën. Kërkesën, e ka arsyetuar...!

Valdete Daka: S'kam kundër por, me të vërtetë është t'u m' duk shumë interesat se çak po bajmë me t'to karika, na me kan stacion i autobusve, sallë dasmave...e, po na duhen karrike...po, s'jam t'u kuptu se cka po bani me t'an k'to karika...Non stop blehen karrike, dollap, taolina dhe s'jam t'u kuptu se cka po ndodh...! N'ashta po e ekzagjeroj por, s'jam t'u kuptu...

Bajram Latifi: Mendoj se brenda KQZ dhe Sekretariatit, duhet të ndryshoj mënyra e punës sepse, ne nëse në fund të përfundimit të aktit diskutojmë, mirë kish qenë që, ngase ne diskutojmë shumë gjëra, të shohim përpara se cka duhet të bëjmë dhe këtë, ta kthejmë në praktikë...Pse ne të bëjmë gjëra të tepërta...? Shumë çështje shkojnë për mes KQZ-së, mirëpo në emër të Sekretariatit! Unë nuk po flas vetëm për kryeshefin, Sekretariatit por edhe për ne...! Duhet të jemi të përgjegjshëm sepse, kur ne ngrisim dorën për të votuar, përgjegjësia bie edhe mbi ne...

Eshref Vishi: Në evidentimin e inventarit që kemi bërë për zyrat e Sekretariatit, a është evidentu një pjesë që është e shkatrrueme në QNR, a është shkatrru krejt, apo vetëm një pjesë, apo janë duke u blerë të reja... A po krijohen stoqe të reja...?

Valdete Daka: Të shkatrrueme e të pashkatrrueme, të përdorshme e të papërdorshme, ato krejt në QNR janë...!

Eshref Vishi: Një pjesë është dashur të hudhet, Sekretariati është dashur të veprojë dhe jo të krijoj stoqe...

Enis Halimi: E vërtetë se, ndosht akemi pasur një ngecje në kuptim të procedimit të shkatrrimit, largimit, procedimit të inventarit, dhe për t'u shkarkuar nga kjo pasuri që jemi të ngarkuar me vite të tëra, ndoshta që prej vitit 2000. Vitin e kaluar, jo në fund të vitit 2015, për herë të parë, është bërë një orvatje për ta evidentu sescilin material: gjendjen e tij, edhe rekomandimin se çka të bëhet me atë material.

Kemi ngecë në vendimmarrje, kurse kjo kërkesë është bërë nga njësia kërkuese për t'i përmbush nevojat.

Eshref Vishi: është dashur që para se kjo kërkesë të vijë këtu, të gjitha shqetësimet, pyetjet është dashur t'i shterrësh në administratë atje. Unë, nuk jam i interesuar që udhëheqësin e njësisë kërkuese, tash me e dëgjuar këtu...!

Enis Halimi: Ne, i kemi shqyrtu çështjet, dhe ka dalë që këto janë të nevojshme. Kjo është argumentuar me të vërtetë se, i duhet njësisë kërkuese...

Sami Hamiti: Cila njësi kërkuese e ka bërë kërkesën për t'i blerë këto karrike këtu, k'tu në sallë...? S'ja ka qëllue hiq, domethënë njësia kërkuese ban kërkesë...po, s'j aka qëllue hiq...zotni...! Nuk po të akuzojmë ty, se ti me ngul po thue...! Bajeni n'i analizë, a është kjo e nevojshme...

Valdete Daka: 100 karrike në sallë...Në QNR, kemi dërgue karrike t'onat, prej zyreve, prej s'di kah...kemi que plotë...tavolina që janë heqë...S'di cka po bani me to..., cka po ndodh...Po e shoh që prapë po don me ble...!

Eshref Vishi: Le të bëhet një kerkresë e detajuar nga njësia kërkuese...

Valdete Daka: E para edhe një pyetje: Sigurimi Kasko i Automjeteve...! Ne e dim që sigurimi i

automjeteve...Ne e dim që shumica e automjete, përpos 5 tjera, janë të vjetra...Dhe, unë po pyes se cila kompani e sigurimit i siguron kasko, kur e dim që automjetet janë të vjetra dhe nuk mundën me u siguru...Ne e dim që t'i merr paratë, por e dime edhe që nuk mundën m'u siguru...Automojeti që e kalon një moshë, nuk mundet me u siguruar...

Ka automjete që janë 12 vjet të vjetra, 13 vjet, tha znj. Daka. Sigurimi kasko i tyre, kushton gati sa vlera e tyre...A është analizu që, këto automojete sa është e arsyeshme ekonomikisht që me investuar në to, nga njëmijë, dymijë euro kur, kret automojeti s'ban njëmijë euro...? Se, po më duket veq gjuajtje e parave dhjetëmijë euro, veq për kasko, plus mirëmbajtja...! Me ato para, mungesh me i ble, dy automjete të reja...

Enis Halimi: Unë kisha me e nda arsyeshmërinë në dy rrafshe: arsyeshmëri në kuptimin moral nuk ka, të gjithë pajtohem për të gjitha automjetet, arsyeshmëri nuk ka sepse, ndoshta edhe këto të reja kan kaluar vitet, por në kuptimin praktik, ne kemi nevojë për përdorimin e tyre. Sekretariati, nuk mund ti përmbushë nevojat e veta të punës..., pra ne kemi nevojë deri sa të gjejmë një solucion tjetër...

Valdete Daka: A e keni shqyrtuar mundësinë që këto vetura që tashmë janë bërë barrë, me u zëvendësuar me vetura të reja që kosoton e kanë shumë më të vogël, dhe arsyeshmëria e tyre është e nevojshme.

Enis Halimi: Në vitin e kaluar ne e kemi ba një propozim për blerje të veturave në vlerë prej 200 mijë euro...!

Valdete Daka: 200 mijë euro...! Ne s'jemi kompani..., edhe kur t'i thuash dikujt kaq shumë, apriori thotë jo...

Enis Halimi: Kemi ba një projeksion, sepse edhe këto që konsiderohen të reja, tani s'jan...

Betim Gjoshi: Krejt këto tema që i keni diskutuar, duhet me u diskutuar në planin e buxhetit...Ne, jemi duke diskutuar për planin e prokurimit...E këtu, duhet me i kërkuar dy gjëra: A janë të sakta afetet e shënuara, dhe a është në përputhje me planin e punës dhe të buxhetit. Dhe për të dyjat, është mirë me na garantuar kryeshefi se, qysh janë...! E treta, KQZ duhet rritur mbikqyrjen, pra gjatë procedurave të mbikqyren specifikat, zhvilimi i procedurave, arsyeshmërija...Përmes komitetit të auditimit, përmes auditorit të brendshëm me u pa se, a janë duke u zhvilluar procedurat konform ligjeve në fuqi. Pastaj, duhe shkuar edhe shpenzimet...

Blerjet, duhet të arsyetohen, le të arsyetohen...Kjo çështje, është dashur të diskutohen në buxhet.

Eshref Vishi: E kam një sugjerim për administratën, e veçmas për prokurimin që, aktivitetet prokuruese të fillojnë me kohë, të përfillen aktivitetet prokuruese. Të jemi shumë të ëvëmendshëm...

Valdete Daka: Jemi në vit zgjedhor, në zgjedhje të rregullta...dhe, nuk mund të themi s'kemi

pasur mundësi, kohë...

Sami Hamiti: Duke e parë implementimin e vitit të kaluar, le të lihen fjalët...! Raporti nëntmujorë, ka qenë shqetësues...Finesat, gjeni si të doni por, shpjegon shkon koha...! Pra, nisni aktivitetet heret: edhe llabat, edhe kabinat...Vit zgjedhor është, duhet të punohet, afate të shkurtuara s'mund të kërkohen...Secila njësi ta kryej punën si duhet, të fillojnë aktivitetet.

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me tri vota apstenimi, planin e prokurimit.

Betim Gjoshi: Le të shënohet në procesverbal se, KQZ ka miratuar një plan pune dhe një plan prokurimi që e ka prurë Sekretariati, pra e kemi aprovu pa ndonjë ndryshim, edhe përgjegjësia është e tyre...

Unë, bëra propozime të caktuara, por asnjë propozim i imi, nuk u pranua. Pse të votoj...!

Valdete Daka: Vazhdojmë...

4.Aktivitet e ZRPP-së

Miradije Mavriti, drejtoresh e ZRPP-së, e njoftoi KQZ-në lidhur me atë se zyra ka përgatitur një rekomandim për pezullimin e 8 partive politike. Edhe pse këto parti, ishin të njoftuar me afatet e pezullimit, ato nuk kanë kërkuar afat shtesë dhe ne, i propozojmë KQZ -së për pezullimin e tyre. Në bazë të ligjit, edhe pas vendimit, këto parti kanë afat prej 20 ditësh, për t'i kryer detyrimet e tyre.

Partitë janë:

- 1. Partia e të Gjelbërvet të Kosovës,*
- 2. Partia Liberale e Kosovës,*
- 3. Partia Nacionale Demokratike e Kosovës,*
- 4. Lëvizja për Bashkim,*
- 5. Lëvizja Demokristiane e Kosovës,*

6. Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar,

7. Kosova Turk Adalet Partisi,

8. Gragjanska Iniciativa.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me një votë apstenimi pezullimin e këtyre partive.

Të ndryshme

Eshref Vishi, paraqiti problemin e parkingut të automjeteve të KQZ. Anëtarët e KQZ-së, diskutuan dhe e analizuan situatën, pa ndonjë alternativë se si do të zgjidhet ky problem.

Ercan Spati, kërkoi që meqë në të ndryshme s'mund të merret vendim, të bëhet një konkluzim që Sekretariati, t'i shoh mundësitë se si të zgjidhet ky problem.

Në këtë aspekt, diskutuan: Betim Gjoshi, Bajram Ljatifi, Sami Hamiti, Enis Halimi.

Valdete Daka: Edhe pse është bërë një çështje monotone, po e ngris përsëri çështjen e pozitave - konkurseve, tash është shtuar edhe një tjetër: pozita e zyrtarit të KKZ-së në Drenas që ka shkuar në pension...!

Në këtë pikë, diskutuan: Valdete Daka, Sami Hamiti, Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Bajram Ljatifi, Eshref Vishi.

Enis Halimi: Kam një çështje, një aktivitet për organizimin një Punëtorie në rrethanat aktuale, e për çështjet tona. Ne, kemi punuar në disa dokumente, të regullore, si dhe të hartimit të disa drafteve...

Lidhur me këtë pikë, në fakt mepërgatitjet, me organizimin, me materialet, me datën etj., diskutuan: Sami Hamiti, Betim Gjoshi, Valdete Daka, Ilir Gashi.

Bajram Ljatifi: Kam Pyetje: A janë aloku mjetet për partitë politike...?

Valdete Daka: Duhet që Sekretariati të kujdeset për këtë çështje, se di...!

Ilir Gashi: Nuk është hera e parë që ndodh vonesa e mjeteve për partitë, për grupet parlamentare. Kjo, duhet të zgjidhet njëherë e mirë. Kryeshefi, mund ta autorizoj personin e caktuar... është papërgjegjësi, pse po vazhdon kështu ky trajtim...?

Lidhur me këtë pikë, diskutuan: Valdete Daka, Betim Gjoshi, Enis Halimi.

Për KOZ

Valdete Daka, kryetare

Adnan Rrustemi, anëtar